



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 1686 / Prot.
15

Tiranë, më 25. 7. 2022

URDHËR

NR. 450, DATË 25. 7. 2022

PËR

HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PUBLIK, TË MESËM TË LARTË, TË ORIENTUAR, PËR NXËNËSIT QË NUK DËGJOJNË, NË FUSHËN E TË NXËNIT TEKNOLOGJI DHE TIK, TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 41 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Kreut I/A të vendimit nr. 662, datë 08.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike”,

URDHËROJ:

1. Hapjen e institucionit arsimor parauniversitar publik, të mesëm të lartë, të orientuar, për nxënës të që nuk dëgjojnë, në fushën e të nxënimit Teknologji dhe TIK, pranë Institutit të Nxënësve që nuk Dëgjojnë, në Bashkinë Tiranë.
2. Ambientet dhe infrastruktura e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar publik të sigurohet në bazë të legjislacionit në fuqi, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.
3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, të realizojë procedurat për emërimin e personelit mësimor të institucionit arsimor parauniversitar publik, të mesëm të lartë, të orientuar, për nxënës të që nuk dëgjojnë, në fushën e të nxënimit Teknologji dhe TIK, bazuar në normat e punës mësimore, të përcaktuar në udhëzimin nr. 30, datë 12.09.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
4. Institucioni arsimor parauniversitar publik, i mesëm i lartë, i orientuar, për nxënës të që nuk dëgjojnë, në fushën e të nxënimit Teknologji dhe TIK, duhet të ketë në ruajtje dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Dokumentacionin themeltar në ruajtje të përhershme dhe të përkohshme, në bazë të legjislacionit në fuqi.
 - b) Rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit.
5. Institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit hapet institucioni arsimor parauniversitar publik, i mesëm i lartë, i orientuar, për nxënësit që nuk dëgjojnë, në fushën e të nxënit Teknologji dhe TIK, të monitorojë veprimtarinë mësimdhënëse të këtij institucioni arsimor parauniversitar publik, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.
 6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës dhe Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

EVIS KUSHI

